



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

|                                |  |
|--------------------------------|--|
| <b>Datë/a:</b>                 | 11.11.2021   |
| <b>Referenc-ë:</b>             | 07-353/04-242056/21  |
| <b>Për/ Za/ To:</b>            | Qendra për ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional – Anton Nrecaj   |
| <b>Përmes/Preko/Through:</b>   | Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit  |
| <b>Nga/ Od/ From:</b>          | Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësirë publike<br>Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit |
| <b>Tema/ Subjekat/Subject:</b> | <b>Pëlqim</b>  |

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokoll 07-353/04-242056/21 nga Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional me përfaqësues Anton Nrecaj me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike sheshi, “Zahir Pajaziti” para Hotel Grandit si dhe vendosja e një tende dhe dy tavolinave me datë 18.11.2021.

Qëllimi i kërkesës është realizimi i kampanjës që ka për qëllim aktivizimin kundër dhunës në familje të identifikoj sfidat e qytetarëve në qasjen e sistemit të drejtësisë dhe ti informoj ata mbi të drejtat e tyre, dhe se si ti qasen mekanizmave të drejtësisë dhe të kërkojnë ndihmë juridike falas.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin Qendrës për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional me përfaqësues Anton Nrecaj për shfrytëzimin e hapësirës publike sheshi, “Zahir Pajaziti” para Hotel Grandit si dhe vendosjen e një tende dhe dy tavolinave me datë 18.11.2021, me qëllim që të identifikojnë sfidat e qytetarëve në qasjen e sistemit të drejtësisë dhe ti informoj ata mbi të drejtat e tyre, dhe se si ti qasen mekanizmave të drejtësisë dhe të kërkojnë ndihmë juridike falas.

**Kushtet e pëlqimit:**

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi;
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e mëparshme.

**Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.**

Faqe 1 nga 1

17.11.2021

Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi, P.N.-10.000 Prishtinë-Kosovë  
<http://www.prishtina-komuna.org>